

Tiranë, më 09.04.2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Shërbim printimi, fotokopjimi dhe skanimi për DRSSH Tiranë”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):

79800000-2.

VLERA E FONDIT LIMIT: 15 090 000 (pesëmbëdhjetë milion e nëntëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a. ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohet në nenin 82 dhe 83 të LLP-së Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe nenet 14/1, 14/2, 25, 26 të V.K.M-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10;*

Argumentimi:Ky kriter u vendos me mbështetje ne nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020“Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”,ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”.*

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3:

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cileneshte e parashikuar se: Pika 1 Neni 83: *Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.* Pika 2 Neni 83: *Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar.*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Sipas shtojcës 9

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më pak se vlera e fondit limit. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra sa vlera e fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/b, neni 55 pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr. 7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore. Në vendosjen e këtij kriteri është mbajtur në vëmendje neni nr. 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, si edhe rekomandimi APP-së nr. 7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin me sukses te kontratën dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2023, 2024, 2025), të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentim: Kriteri vendoset bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomik kanë kapacitetin financiar për zbatimin e marrëveshjes kuadër.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar marrëveshjen kuadër, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të deklarojnë se disponojnë pajisjet e nevojshme (sipas specifikimeve teknike të shprehura në shtojcën Nr.6) për zbatimin e kontratës, si vijon:

Nr.	Përshkrimi	Nj/M	Sasia
-----	------------	------	-------

1	Fotokopje/Printer/Skaner/ Lazer/Bardh/zi	cope	40
2	Fotokopje/Printer/Skaner Lazer/me ngjyra	cope	20
3	Fotokopje/Printer/Skaner Lazer/Bardh/zi	cope	5
	Shuma e pajisjeve	cope	65

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet:

- a. Deklarate ku të cilesohet prodhuesi i paisjeve dhe nese keto pajisje ofertuesi i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje.
- b. katalog/skedë teknike të prodhuesit, ku të tregohen qartë karakteristikat e pajisjeve, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara.

Shenim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor, ofertuesi i kualifikuar i pari, duhet të paraqesë (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë) për pajisjet e deklaruara.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion pajisjet për kryerjen e shërbimit për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Pajisje të kërkuara nga autoriteti kontraktor përfitues fundor i këtij shërbimi. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar shërbimin e kërkuar si dhe për të verifikuar plotësimin e specifikimeve teknike të shërbimeve, objekt prokurimi.

2.3.3 Operatorët ekonomikë duhet të ketë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e e shërbimit objekt prokurimi, si më poshtë:

- a. 2 (dy) inxhinierë të fushës së teknologjisë së informacionit IT, informatikës, inovacionit, elektronikës apo mekanik. Për këta punonjës të paraqitet diploma e kërkuar dhe kontrata e punës e vlefshme me operatorin ekonomik ofertues.
- b. 2 (dy) punonjës teknikë të cilët do të kryejnë funksionin e mirëmbajtjes së paisjeve dhe do të realizojnë asistencën teknike gjatë kryerjes së shërbimit. Për këta punonjës të paraqitet kontrata e punës e vlefshme me operatorin ekonomik ofertues.
- c. 2 (dy) nga punonjësit e mesipër të përmendur në pikën a dhe b, duhet të jenë të trajnuar/certifikuar nga prodhuesit apo distributorët e autorizuar të paisjeve (pika 2.3.2 tabela nr.1-3) të ofertuara në këtë procedurë prokurimi ose nga organe të akredituar kompetente, për shërbim mirëmbajtje printerash apo pajisjesh elektronike. Në lidhje me këta punonjës të paraqitet edhe certifikimi përkatës.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Deklarata provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kjo kërkesë vjen si kusht kryesor për kapacitetin profesional të operatorëve ekonomik ofertues. Profili i kërkuar lidhet ngushtë me objektin e prokurimit dhe lë të hapur çdo fushë të teknologjise së informacionit, elektronikës, inovacionit dhe çdo fushë tjetër të diplomimit në Shqipëri dhe ndërkombëtarisht që lidhet me objektin e prokurimit që është shërbim printimi dhe fotokopjimi. Kërkesa për punonjësit teknik i shërben zbatimit në terren të kontratës, të cilët do të jenë në gadishmeri për çdo pyetje, paqartësi, defekt apo çdo nevojë që lind gjatë zbatimit të kësaj kontrate. Shërbimi do të shtrihet në disa vende të ndryshme, ndaj kërkohet strukturë teknike e mjaftueshme që të mund të mbulojë të gjitha zonat në mënyrë të njëkohshme. Pas vendosjes së printerëve, nevojitet monitorim dhe mirëmbajtje. Inxhinierët e fushave të mësipërme janë të aftë të realizojnë zbulimin e defekteve, zëvendësim të komponentëve elektronikë/mekanikë etj. Printerët që përdoren në institucione publike mund të përpunojnë dokumente konfidenciale, Inxhinierët e IT dhe sigurisë mund të garantojnë që pajisjet të konfigurohen në mënyrë që të respektojnë protokollet e sigurisë dhe privatësisë, duke parandaluar rrjedhje informacioni. Ky është një shërbim me shtrirje të gjerë, që kërkon punonjës të certifikuar për të garantuar cilësi, siguri dhe vazhdimësi. Shpërndarje gjeografike e bën të pamundur mbulimin nga një numëri më të vogël të stafit pa rrezikuar cilësinë dhe kohëzgjatjen e reagimit.

Çertifikimi/trajnimi shërben si dokument provues dhe garantues për OE duke duke siguruar që punonjësit e tij, të cilët do të përfshihen në procesin e ekzekutimit të kontratës kanë njohuritë e nevojshme profesionale mbi printerat objekt prokurimi si dhe janë kompetentë për konfigurimin dhe mirëmbajtjen e tyre në përputhje me standardet teknike si dhe në harmoni me protokollet e sigurisë dhe privatësisë, duke parandaluar çdo rrjedhje të mundshme të informacionit që mund të ndikojë në funksionimin, performancën dhe stabilitetin e institucionit. Gjithashtu me qëllim pjesëmarrjen e gjerë të Operatorëve ekonomik, Autoriteti Kontraktor ka parashikuar se ky çertifikim/trajnim të jetë realizuar nga prodhuesit apo distributorët e autorizuar të paisjeve apo nga organe të akredituar kompetente, për shërbim mirëmbajtje printerash apo pajisjesh elektronike. Autoriteti Kontraktor ka parashikuar disa subjekte ekuivalente të cilat identifikohen si: Prodhues ose Distributor i autorizuar për pajisjet e parashikuara në këtë procedurë prokurimi ose Organe të akredituara kompetente për shërbim mirëmbajtje printerash apo pajisjesh elektronike.

Për sa më sipër, evidentohet se kërkesa e AK në lidhje me çertifikimin/trajnimin është në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik në proporcion me objektin e prokurimit si dhe në harmoni me parimet e sanksionuara në LPP. Njesia e Prokurimit ka përcaktuar si kriter të domosdoshëm për kualifikim angazhimin e stafit teknikë të specializuar për realizimin e shërbimit të mirëmbajtjes dhe asistencës teknike duke pasur parasysh shtrirjen gjeografike të shërbimit, vëllimin e punës dhe kompleksitetin teknik, nevojën për ndërhyrje të shpejtë dhe të koordinuar, rëndësinë e vazhdimësisë së shërbimit për institucionin përfitues.

2.3.4 Operatoret ekonomike duhet të duhet të paraqesin një deklaratë me anë të së cilës të deklarojnë se riparimi i pajisjes së difektuar do të realizohet sipas përcaktimeve të vendosura në specifikimet teknike.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i cili lejon Autoritetin/entitetin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në

varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, me qëllim që AK të krijojë siguri për që ofertuesi merr përsipër ekzekutimin e kontratës, sipas të gjitha kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike.

2.3.5 Operatorët ekonomike duhet të duhet të paraqesin një deklaratë me anë të së cilës të deklarojnë se marrin përsipër transportin e pajisjeve të kërkuara në pikën 2.3.2 në adresën e Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i cili lejon Autoritetin/entitetin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, me qëllim që AK të krijojë siguri për që ofertuesi merr përsipër ekzekutimin e kontratës, sipas të gjitha kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, termat e referencës dhe përlllogaritja e fondit limit janë përgatitur dhe hartuar nga Autoriteti Kontraktor Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar. Grupi i punës ka argumentuar specifikimet si më poshtë:

❖ **Specifikimet teknike për pajisjet dhe që do të përdoren në këtë procedurë.**

1) **40 pajisje -A4 me keto specifikime :**

Fotokopje/Printer/Skaner	
Teknologjia	Lazer/Bardh/zi

Shpejtesia jo me e vogel:	30faqe/min
Ekrani jo me i vogel se:	7 inch
Resolucioni	1200x1200 dpi
Dimensioni W x D x H , jo me i madh se:	480x485x510
Kapaciteti mbajtes i syrtareve	Jo me i vogel 500faqe
Kapaciteti ne dalje	Jo me e vogel 250faqe
Madhesia e letres	A6-A4
Memorja jo me i Vogel:	2 GB
HDD - Hardisk jo me ivogel	320 GB
Aplikacione	Pajisja duhet te mundesoj instalimin e aplikacioneve te ndryshme, duke perfshire dhe aplikacion per monitorim apo menaxhim printimi.
Connection	Ethernet, USB
Mundesi skanimi ne HDD	Pajisja duhet te mundesoje skanimin ne HDD e saj dhe krijimin e folderave te ndryshem per secilin perdorues
Skanimi: SPDF-single pas document feeder (skanimi i njehershem te dy aneve te letres)	Full Network color Scan (Scan to e-mail, scan to folder, Scan to USB,)
Kapaciteti SPDF	50 faqe
Mobile printing(aftesi printimi nga celulari)	Apple AirPrint, Google Cloud Print,Mopria
Secure printing	Pajisja duhet te mundesoje encryptimin te hardiskut per ruajtjen e informacionit te printim/skanim/fotokopjim.
Printimin ne te dyja anet (Duplex)	Po
Pajisja te mundesoje skanimin e dokumentave direct ne Dropbox, Sharepoint, icloud, etc.	

2) **20 pajisje me ngjyra-A4 me keto specifikime**

Fotokopje/Printer/Skaner	
--------------------------	--

Teknologjia	Lazer/me ngjyra
Shpejtesia:	30 faqe/min
Ekrani jo me i vogel se:	7 inch
Resolucioni	1200x1200 dpi
Dimensioni W x D x H , jo me i madh se:	500x585x510
Kapaciteti mbajtes i syrtareve	Jo me ivogel 250faqe
Kapaciteti ne dalje	Jo me e vogel 200faqe
Madhesia e letres	A6-A4
Memorja jo me i Vogel:	2 GB
HDD - Hardisk jo me ivogel	320 GB
Aplikacione	Pajisja duhet te mundesoj instalimin e aplikacioneve te ndryshme, duke perfshire dhe aplikacion per monitorim apo menaxhim printimi.
Connection	Ethernet, USB
Mundesi skanimi ne HDD	Pajisja duhet te mundesoje skanimin ne HDD e saj dhe krijimin e folderave te ndryshem per secilin perdorues
Skanimi: SPDF-single pas document feeder (skanimi i njehershem te dy aneve te letres)	Full Network color Scan (Scan to e-mail, scan to folder, Scan to USB)
Kapaciteti SPDF	50 faqe
Mobile printing(aftesi printimi nga celulari)	Apple AirPrint, Google Cloud Print,Mopria
Secure printing	Pajisja duhet te mundesoje encryptimin te hardiskut per ruajtjen e informacionit te printim/skanim/fotokopjim.
Printimin ne te dyja anet (Duplex)	Po
Pajisja te mundesoje skanimin e dokumentave direct ne Dropbox, Sharepoint, icloud, etc.	

3) 5 pajisje –A3 me keto specifikime :

Fotokopje/Printer/Skaner	
Teknologjia	Lazer/Bardh/zi
Shpejtesia:	30 faqe/min
Ekrani jo me i vogel se:	7 inch
Resolucioni	1200x1200 dpi

Dimensioni W x D x H , jo me i madh se:	380x500x700
Kapaciteti mbajtes i syrtareve	Jo me i vogel 500 faqe
Kapaciteti ne dalje	Jo me e vogel 250 faqe
Madhesia e letres	A6-A3
Memorja jo me i Vogel:	2 GB
HDD - Hardisk jo me i vogel	320 GB
Aplikacione	Pajisja duhet te mundesoj instalimin e aplikacioneve te ndryshme, duke perfshire dhe aplikacion per monitorim apo menaxhim printimi.
Connection	Ethernet, USB
Mundesi skanimi ne HDD	Pajisja duhet te mundesoje skanimin ne HDD e saj dhe krijimin e folderave te ndryshem per secilin perdorues
Skanimi: SPDF-single pas document feeder (skanimi i njehershem te dy aneve te letres)	Full Network color Scan (Scan to e-mail, scan to folder, Scan to USB)
Kapaciteti SPDF	50 faqe
Mobile printing(aftesi printimi nga celulari)	Apple AirPrint, Google Cloud Print,Mopria
Secure printing	Pajisja duhet te mundesoje encryptimin te hardiskut per ruajtjen e informacionit te printim/skanim/fotokopjim.
Printimin ne te dyja anet (Duplex)	Po
Pajisja te mundesoje skanimin e dokumentave direct ne Dropbox, Sharepoint, icloud, etc.	

Argumentim per vendosjen e specifikimeve kryesore te pajisjeve:

- Shpejtesia jo me e vogel se 30 faqe ne min.

Ne lidhje me shpejtesine AK ka gjykuar se shpejtesia jo me e vogel se 30 faqe ne min eshte nje shpejtesi e e mesme e cila ben te mundur printimin e materialeve ne nje kohe eficente.

- Rezolucioni 1200 x 1200 dpi

Rezolucioni 1200 x 1200 dpi perkon me cilesine e printimit e cila tashme eshte bere standart per cdo pajisje e viteve te fundit.

- Dimensioni W x D x H , jo me i madh se:

Per arsye te hapesires se vogel te zyrave dhe vendosjes se tyre mbi tavolinat e punes AK kontraktor ka vendosur nje maksimum te dimensioneve te pajisjeve te cilat do sillen nga OE. Duke gene se pajisjet office do vendosen mbi tavolina e punonjesve, hapesire e cila eshte kufizuar AK ka vendosur kufijte maksimal te pajisjeve, por nuk pengon qe te pranohen pajisje me dimensione me te vogla.

- Ekranin jo me i vogel se 7 inch kerkohet per arsyet e meposhtme :

Ekranet mbi 10.1 inch ofrojne dhe perdorimin touch dhe jane teknologji te fundit ne pajisjet office. Perdorimi i tyre ben te mundur efikasitetin ne maksimum te tools-ve (opsioneve qe ofron pajisja), dhe settings -ve (parametrave te pajisjes). Madhësia e ekranit ka lidhje me perdorimin e opsioneve nga operatori. Nje Ekran me dimension me te vogel e ben pajisjen jo shume te perdorshme nga perdoruesi e cila sjell dhe humbje kohe gjate proceseve te punes. Ky ekran lejon gjithashtu te instalohen manuale perdorimi te pajisjes ne formate video dhe pdf dhe programe te tjera qe ofrohen nga prodhuesi. Gje e cila sjell nje lehtesi per perdoruesin pa qene nevoja per ndihme nga suporti.

- Kapaciteti mbajtes i syrtareve (jo me i vogel se)

Kapaciteti mbajtes i syrtareve eshte gjykuar sipas tipologjise se pajisjes eshte gjykuar qe te vendoset jo me e vogel se , pra eshte vendosur nje minimum por nuk pengohet qe te sillet me kapacitet me te madh.

- Kapaciteti ne dalje i syrtareve (jo me i vogel se),

Edhe ky specifikim sipas tipologjise se pajisjes eshte vendosur jo me e vogel se, pra eshte vendosur nje minimum por nuk pengohet qe te sillet me kapacitet me te madh.

- Memorja jo me e vogel 2 GB

Duke qene se pajisja perdoret nga disa operator njehersh memorja e kerkuar duhet te ofroje procesim sa me te shpejte te dokumentave duke mos penguar operatoren e tjere qe jane ne pritje. Duke ditur si funksionon nje pajisje sa me madhe te jete kjo memorje aq me shpejt pajisja eshte funksionale per operatoren e tjere. Memorja e kerkuar ben te mundur qe pajisja te procesoje ne nje kohe shume te shkurter nje material ne formate te ndryshme, gje e cila sjell mbarevajtjen ne proceset e puneve. Gjithashtu kjo memorje ben te mundur mosbllokimin e pajisjeve gjate printimeve me volum te larte MB. Nje memorje me e vogel rrit mundesine e bllokimit te pajisjes dhe automatikisht pengimin e proceve te punes.

- Hardisku jo me i vogel se 320

Hardisku jo me i vogel se 320 ben te mundur operimin e pajisjes nga disa operator njekohesisht, pavarsisht nga madhësia e dokumentit qe kerkohet te printohet. Gjithashtu ky hardisk ben te mund dhe volume te larta skanimi ne te njejten kohe. Ky hardisk lejon gjithashtu instalim e programeve te ndryshme ne pajisje. Me pak fjale ky hardisk nuk kufizon perdoruesin per perdorimin ne maksimum te pajisjes.

- Skanimi: SPDF-single pas document feeder (skanimi i njehershem te dy aneve te letres)

Skanimi ne sisitemin spdf eshte sistemi i skanimit te njehershem te letres ne rastin kur ajo eshte e printuar duplex, pasi pajisja eshte e pajisur me dy skanere e cila e lexon letren njekohesisht. Ky lloj sistemi i skanimit lehteson jashtezakonisht shume skanimin e dokumentave , lehteson punen e perditshme, dhe kufizon problematikat e skanimit tek perdoruesit.

- Shpejtesia e skanimit jo me e vogel se:

Per kapacitetin mbajtes eshte gjykuar te jete jo me i vogel se sipas tipologjise se pajisjes, per arsye te madhësise se nje dokumenti per tu skanuar, por nuk pengohet qe te vije sillet me nje volum me te larte skanimi.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afatin përfundimtar për dorëzimin e ofertave. Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP, për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt.